



Qendra e Shërbimit Administrativ

11303 Greendale
Sterling Heights, MI 48312
Phone: (586) 797-1000
Fax: (586) 797-1101
www.uticak12.org

Robert S. Monroe
Interim Superintendent

23 Nëntor, 2020

I Dashur Prind/Kujdestar,

Pushimet këtë vit do të sjellin një pushim shumë të nevojshëm dhe një ndjenjë rinovimi që përfaqëson ky sezon. Edhe pse e presim me padurim këtë kohë, ne e pranojmë se pandemia globale do të vazhdojë të na sfidojë me pasiguri dhe ndryshim.

Një nga fushat ku dëshiroj të sjell qartësi dhe qëndrueshmëri është në lidhje me statusin e planit tonë të të mësuarit. Duke pasur parasysh mjedisin aktual lokal që lidhet me COVID-19, studentët do të vazhdojnë të jenë në një mjedis të mësimin në distancë deri të **Premten, 15 Janar 2021**. Plani ynë aktual është që studentët të kthehen përsëri në klasa duke filluar të **Martën, 19 Janar 2021** pas Ditës së Martin Luther King, Jr.

Ju lutemi mbani në mendje se qëllimi ynë mbetet një mjedis të mësuarit në person për studentët tanë. Nuk ka përgjigje të lehta dhe ne e respektojmë që pandemia mund të jetë burimi i pikëpamjeve të forta kundërshtuese. Është e rëndësishme që ne të vazhdojmë të punojmë në partneritet, me respekt dhe një përkushtim ndaj studentëve tanë. Për të siguruar transparencë, unë dua të ndaj pikat e mëposhtme që informojnë procesin tonë të vendimmarrjes:

Shëndeti dhe Siguria

Po të vizitoni portalin [community dashboard](#), do të vini re rritjen e faktorëve të shëndetit dhe sigurisë. Këto prirje parashikohet të vazhdojnë gjatë sezonit të festave dhe më pas. Ndërsa fëmijët dhe adoleshentët zbulohet se janë në një rrezik më të ulët për COVID-19, ne pranojmë që sëmundja përhapet shpejt tek individët brenda kategorive më të larta të rrezikut. Në rastin e UCS, kjo ndikon shumë anëtarëve tanë të stafit të cilët mbështesin dhe kujdesen për studentët tanë çdo ditë.

Stabiliteti dhe Vazhdimësia e të Mësuarit

Tranzicioni nga udhëzimet në person në ato në distance mund të jetë i vështirë dhe përçarës për të gjithë të përfshirë. Informacioni që po ndajmë sot do të sigurojë kohë për planifikim dhe qëndrueshmëri për studentët, stafin dhe familjet tona në mënyrë që të gjithë të dimë se çfarë të presim gjatë muajve të ardhshëm.

Burime për të Përbushur Nevojat e Studentëve tanë

Kur COVID-19 futet në ndërtesat e komunitetit tonë, ne ndjekim udhëzimet e Departamentit të Shëndetit të Qarkut Macomb për individët që mund të kenë pasur ekspozim. Kjo sjell që studentët, mësuesit dhe anëtarët e stafit të vendosen në karantinë për 14 ditë. Si rezultat UCS dhe rrethet përreth përballen me probleme të rëndësishme për të gjetur personelin zëvendësues për të vazhduar udhëzimet në person dhe për të mbështetur operimin e qarkut të shkollës

Utica Community Schools Board of Education

Robert A. Ross, Ph.D., *President* Mary K. Thomas, Ph.D., *Vice President* Michele Templeton, *Treasurer* Denyeal Nesovski, *Secretary*
Jennifer L. Prybys, *Trustee* Kimberly Becker, *Trustee* Kelli Rankin, *Trustee*

Duke punuar si Komunitet për të Ngadalësuar Përhapjen

Siç kanë vërejtur drejtuesit e sistemeve tona shëndetësore, për arsye të papërgjegjësive së përbashkët të komunitetit, spitalet po mbingarkohen dhe studentët, familjet dhe anëtarët e stafit tonë vihen në një rrezik më të lartë. Është e rëndësishme që ne *të gjithë* të punojmë së bashku për të ndjekur strategjitë e duhura për të ulur dhe të sigurojmë zvogëlimin e përhapjes në tërë komunitet në nivele ku mund të kthehemi edhe një herë në të mësuarit në person.

Një kthim në mes të Janarit na siguron një distancë të përshtatshme nga pikat e parashikuara gjatë sezonit të festave. Duke pasur parasysh pasigurinë e mjedisit të COVID-19, ne do të vazhdojmë të monitorojmë faktorët e shëndetit dhe sigurisë për të përcaktuar mundësinë e kthimit të studentëve ose grupeve të studentëve në një datë më të hershme. E di që të gjithë jemi të irrituar, madje edhe të rraskapitur, nga kjo pandemi globale. Sidoqoftë, angazhimi ynë i përbashkët për të punuar për të zvogëluar përhapjen e COVID-19 dhe lajmet për një vaksinë të mundshme mund të na sigurojë një ndjenjë optimizmi dhe shprese.

Komuniteti ynë ka shumë për të festuar këtë festë të Thanksgiving apo Falenderimit. Jam krenar që shoh qëndrueshmërinë e vazhdueshme të fëmijëve tanë dhe angazhimin e stafit dhe familjeve tona për të ndihmuar studentët të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Ju uroj ju dhe familjes tuaj më të mirën dhe Gëzuar Sezonin e Festave

Urime të Përzemërta,



Robert S. Monroe

Interim Superintendent